



REPubLIKA E KOSOVËS
REPubLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETAFEVË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 31232
U. Br.

Nr. i faq. 4 Data: 29/09
Br. str. KAMENICË/A 2022



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR BASHKFINANCIM TË PROJEKTIT

“Realizimin e Litarit Rrëshqitës në fshatin Ruboc”

Palët nënshkruese

1. Komunës së Kamenicës, e përfaqësuar nga Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
2. Swisscontact, e përfaqësuar nga Fisnik Bajrami, Menaxher i Projektit “Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes” - FEGO, Prishtinë.

Neni 1

Qëllimi

Komuna e Kamenicës dhe Swisscontact – Projekti “Nxitja e Mundësive të Punësimit dhe Rritjes” – FEGO lidhin këtë memorandum mirëkuptimi, me qëllim të bashkëpunimit për zhvillimin e sektorit të turizmit.

Komuna e Kamenicës, ka ndarë një pjesë të fondeve për vitin 2022, për realizimin e projekteve zhvillimore brenda sektorit të turizmit.

Swisscontact, nëpërmjet projektit FEGO, të financuar nga qeveria Suedeze, e ka përzgjedhur rajonin e Kamenicës dhe fshatërat përreth në Komunën e Kamenicës, si një ndër destinacionet e përshtatshme për zhvillimin e produkteve turistike dhe përmirësimin e menaxhimit të resurseve natyrore ekzistuese.

Komuna e Kamenicës është përfituese e një granti të MAPL, për projektin “Lugu i Verdhë - lidhja e fshatrave të Komunës së Kamenicës me fshatrat e Komunës së Novobërdës përmes ndërtimit të shtegut të biciklistëve” përmes së cilës do të investojnë në ndërtimin e shtegut të biciklistëve i cili fillon në fshatin Ruboc të Komunës së Kamenicës deri në fshatin Kllobukarë të

K.R.

Komunës së Novobërdës. Përgjatë këtij shtegu, Komuna e Kamenicës ka potencial dhe ka shprehur vullnetin për të bashkëpunuar në projekte që rrisin edhe fluksin e turistëve.

FEGO do të angazhohet të bashkëpunojë me Komunën e Kamenicës në bashkëfinancimin e projektit turistik në rajonin e Kamenicës, përkatësisht realizimin e litarit rrëshqitës në fshatin Rubovc të kësaj Komune. Për të realizuar këtë projekt, Swisscontact dhe Komuna e Kamenicës do të bashkëpunojnë me ekspertë për projektimin dhe zhvillimin e produktit turistik si dhe për vlerësimin e potencialit turistik të rajonit. Këto aktivitete të përbashkëta kanë për qëllim të kontribuojnë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Komunën e Kamenicës, rritjen e të hyrave në sektorin privat, dhe rritjen e punësimit.

Neni 2

Përgjegjësitë e palëve

1. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, secila prej palëve zotohet t'i zbatojë përgjegjësitë e mëposhtme, me qëllim të realizimit sa më të mirë dhe efikas të qëllimit të këtij bashkëpunimi.
2. Komuna e Kamenicës do të angazhohet për:
 - 2.1 Bashkëpunimin rreth zhvillimit të projektit ideor të litarit rrëshqitës
 - 2.2 Bashkëfinancimin e realizimit të litarit rrëshqitës. Bashkëfinancimi nga Komuna e Kamenicës do të bëhet nga Kodi 50188 Participimi me Donatorë.
 - 2.3 Bashkëpunimin me Projektin FEGO rreth studimit për vlerësimin e potencialit turistik të fshatërave Busavatë dhe Ruboc, dhe rekomandimet e produkteve turistike të përshtatshme për zhvillim në këto rajone.
 - 2.4 Organizimin e aktiviteteve mobilizuese për promovimin e praktikave të ruajtjes së ambientit dhe hartimin e planeve konkrete për grumbullimin e mbeturinave në rajonet e lartëpërmendura.
 - 2.5 Komuna e Kamenicës do të transferojë mjetet në vlerë të €20,000 në llogarinë e mëposhtme:

Bank name: ProCredit Bank Kosovo

Account name: SWISSCONTACT NGO

Account number: 1110118206000111

3. Swisscontact do të:

- 3.1 Financojë studimin për vlerësimin e potencialit turistik të rajonit dhe rekomandimet e produkteve turistike të përshtatshme për zhvillim në këto rajone.
- 3.2 Financojë planin ideor për zhvillimin e produkteve turistike që do të përfshijë matjet gjeodezike, vlerën e projektit, projektin ekzekutiv, paramasën, paralogarinë, dhe elementet e tjera përcjellëse për finalizimin e projektit.

3.3 Bashkëfinancojë zhvillimin e produktit turistik të litarit rrëshqitës sipas projektit të zhvilluar.

3.4 Përkrah Komunën e Kamenicës në iniciativat e përbashkëta për zhvillimin e turizmit rural në këtë rajon.

4. Ndarja e përgjegjësiwe buxhetore në mes dy palëve:

Të dy palët zotohen për alokimin e buxhetit për zbatimin e aktiviteteve të listuara përgjatë këtij memorandumit. Swisscontact, në kuadër të projektit FEGO, do të kontribuojë me rreth 57.6% të vlerës investuese, për zhvillimin e projektit, realizimin e litarit rrëshqitës dhe studimit të potencialit turistik në këtë rajon. Si rezultat i përkrahjes prej 57.6% projekti FEGO do të bëjë përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve që nevojiten për zhvillimin e produktit/projektit turistik. Komuna e Kamenicës do të mbulojë 42.5% të kostove të asociuara me zhvillimin e projektit dhe realizimin e produktit litari rrëshqitës, si dhe studimin për zhvillimin e produkteve dhe potencialit turistik në Komunën e Kamenicës për të cilat dy palët dakordohen në këtë marrëveshje. *Mbulimi i kostove të lartëpërmendura përfaqëson pjesën e vlerësuar bazuar në vlerësimin e kostove.*

Projektet që planifikohen të implementohen përgjatë kohëzgjatjes së këtij bashkëpunimi janë të listuara në tabelën më poshtë:

Aktivitetet:	Çmimi:	Ndarja e shpenzimeve
Zhvillimi i projektit ideor për realizimin e litarit rrëshqitës dhe matjet gjeodezike	€ 3,590	FEGO
Realizimi i litarit rrëshqitës	€ 40,000 ¹	FEGO (€ 20,000) dhe Komuna e Kamenicës (€ 20,000)
Studimi për zhvillimin e produkteve dhe potencialit turistik në Komunën e Kamenicës	€ 3,600	FEGO
TOTAL:		€ 47,190

Neni 3

Koordinimi dhe konsultimet

Palët pajtohen që gjatë implementimit të kësaj marrëveshje, do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen rregullisht (të paktën një here në muaj) për të vlerësuar efektivitetin e mbështetjes nga FEGO dhe dinamikat e implementimit të marrëveshjes.

¹ Shuma e paraqitur në këtë tabelë është shuma e vlerësuar bazuar në ofertat e mëhershme të investimeve të kryera nga Swisscontact në Kosovë dhe si e tillë, mund të ndryshojë pas marrjes së ofertave finale.

Çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me administrimin dhe implementimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit do të zgjidhet nëpërmjet konsultave të palëve në fjalë.

Neni 4

Provizionet e përgjithshme

1. Amandamenti apo shkëputja e marrëveshjes: Palët kanë të drejtë të shkëpusin pjesëmarrjen në marrëveshje duke dërguar paralajmërim me shkrim 30 ditë më herët.
2. Data e Hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja: Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët me kohëzgjatje deri më 31 Dhjetor 2022.
3. Përfaqësimi: Palët do të përfaqësohen nga personat e mandatuar nga nënshkruesit e marrëveshjes.

Neni 5

Pëlqimi i palëve

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
2. Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshje, do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

Kadri RAHIMAJ

Fisnik BAJRAMI,


Kryetar i Komunës së Kamenicës


Menaxher i projektit FEGO
swisscontact